



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3, par.1, pika b të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000, nenit 19, par.1, pika b, dhe nenit 40 të Statutit dhe Rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 21.02.2006 merr

V E N D I M

MBI CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E KATËR OBJEKTEVE TË TËRËSISË SË PËRBASHKËT (KOLEKTIVE) NË FSHATIN GRAÇANICË

Neni 1

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e katër objekteve të tërësisë së përbashkët (kolektive) në fshatin Graçanicë .

Neni 2

Lokacioni për ndërtimin e objektit, sipas këtij Vendimi, përfshinë pjesën e ngastrës kadastrale nr. 597/1, Zona kadastrale-Graçanicë, fleta poseduese nr. 499, në sipërfaqe përafërsisht prej 54.0 arë, e evidencuar si pronë shoqërore-pasuri e fshatit.

Neni 3

Destinimi i caktuar i lokacionit, sipas këtij Vendimi, do të inkorporohet në planin e ardhshëm zhvillimor të komunës së Prishtinës dhe në Planin rregullativ për këtë zonë.

Neni 4

Ky Vendim paraqet bazë për dhënien e pëlqimit në lokacion, lëshimin e lejes urbanistike dhe lejin e ndërtimit të objekteve investive për të cilin është caktuar lokacioni sipas këtij Vendimi.

Neni 5

Kushtet dhe kriteret për ndarjen e banesave bëhen nga komisioni përkatës i formuar nga ana e Bordit të drejtorëve dhe Zyrës së komuniteteve në Graçanicë

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës. Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë dhe Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë të Komunës së Prishtinës të cilët do të kryejnë veprime nga përgjegjësitë e tyre të caktuara për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr.353-87, më 21.02.2006

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri